

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER XHOANA OMARI
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 10, RR. MINE PEZA, GODINA NR.
1, APARTAMENTI NR. 1
TEL: 0682055130

KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 4687

Nr. koleksioni: 2687

Tirane më 13/09/2025

Referues:

- gji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- gji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- gji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2025053810298297531



A2025053810298297531

KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

Sot, para meje Notere XHOANA OMARI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINISTRATIVE NR. 10, RR. MINE PEZA, GODINA NR. 1, APARTAMENTI NR. 1, u paraqit personalisht:

PALA DHURUESE:

Ozkan Kiper, shtetas turk, lindur në Diyarbakir më 01/01/1990, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte turke me nr. U34402614, në cilësinë e ortakut dhe zotëruesit të 1 kuote me vlerën e 100% të kapitalit të shoqërisë "Babil" Sh.p.k, me NUIS M51407505. Asubjekt i së drejtës shqiptare, regjistruar si person juridik pranë Regjistrat Tregtar të Qendrës Kombëtare të Bizneseve

(këtu e në vijim referuar si "*Dhuruesi*").

PALA PRANUESE E DHURIMIT:

Eda Kiper, shtetase turke, lindur në Konak më 19/03/1991, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte turke me nr. U88071354.

(këtu e në vijim referuar si "*Pranuesi*").

Palët ranë dakort për hartimin dhe nënshkrimin e kontratës së dhurimit të kuotës së Dhuruesit me vlerën e 100 % (njqind përqind) të kapitalit të shoqërisë "Babil" Sh.p.k në pronësi të ortakut te vetem **Ozkan Kiper mbështetur dhe si pasojë e marrëdhënies së ngushtë miqësore që ata kanë me njëri-tjetrin, si dhe për shkak të bashkëpunimit të vazhdueshëm që kanë patur në të shkuarën.**

Për sa më sipër, Palët vendosën si më poshtë vijon:

NENI 1

OBJEKTI I KONTRATËS

- 1.1 Objekt i kësaj kontrate është transferimi i pronësisë nga Dhuruesi tek Pranuesi, sipas kushteve dhe termave të përcaktuara nëpërmjet kësaj kontrate, të:
 - kuotës së Dhuruesit me vlerën e 100 % të kapitalit të shoqërisë "Babil" Sh.p.k; si dhe
 - çdo të drejte që i përket kësaj përqindje, si dhe cdo detyrim, pa asnjë kundërshpërblim.
- 1.2 Transferimi i pronësisë mbi përqindjen e kuotës së parashikuar në këtë Kontratë do të kryhet në ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate nga Palët.

NENI 2

DETYRIMET E PALËVE NË LIDHJE ME TRANSFERIMIN

Për transferimin e pronësisë sipas kësaj kontrate:

a) Dhuruesi do të:

i. Dorëzojë gjithë dokumentacionin ligjor, ekonomik – financiar dhe teknik të shoqërisë në datën e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

Dhe

b) Pranuesi:

i. Do të realizojë të gjitha ndryshimet përkatëse të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar, si dhe në të gjitha institucionet dhe regjistrat përkatës ku shoqërisë i lind detyrimi të pasqyrojë ndryshimet që rrjedhin nga kjo kontratë.

ii. Pranuesi njeh dhe pranon që shoqëria ka detyrime tatimore të papaguara

Në përfundim, Pranuesi do të fitojë titullin e pronësisë mbi kuotën e Dhuruesit, me vlerën e 100% të kapitalit të Shoqërisë "Babil" Sh.p.k në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe do të gëzojë të gjitha të drejtat e tjera që lidhen me të si dhe detyrimet.

Në përfundim, Pranuesi do të rezultojë ortak i 1(nje) kuote me vlerën e 100% të kapitalit të Shoqërisë "Babil" Sh.p.k.



A2025053810298297531

NENI 3

DEKLARIMET DHE GARANCITË E DHURUESIT

- 3.1 Deklaratat dhe Garancitë e Dhuruesit në datën e Nënshkrimit të marrëveshjes, janë si vijon:
- 3.1.1 Dhuruesi konsiderohet në mbarëvajtje sipas legjislacionit në Republikën e Shqipërisë.
- 3.1.2 Kuota është nënshkruar rregullisht, është paguar plotësisht si dhe është e lirë dhe e çliruar nga çdo barrë. Shoqëria ka kufizime tatimore të cilat pranohen nga pala pranuese e dhurimit.
- 3.1.3 Sipas dijenisë së Pranuesit, Dhuruesi ka depozituar, në përputhje me normat përkatëse, të gjitha deklaratat e kërkuara nga Legjislacioni Tatimor dhe ai për sigurimet shoqërore, depozitimi i të cilave duhej bërë përpara datës së kësaj marrëveshjeje dhe përmbajtja e tyre është e saktë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 3.2 Dhuruesi garanton Pranuesin për vërtetësinë e të gjithë informacionit në këtë nen.

NENI 4

DEKLARIMET DHE GARANCITË E PRANUESIT

- 4.1 Pranuesi deklaron dhe garanton Dhuruesin si më poshtë:
- a. Pranuesi ka:
- (i) kompetencat dhe autoritetin për të kërkuar dhe vepruar sipas kësaj kontrate dhe çdo dokumenti tjetër që duhet të ekzekutohet në lidhje me të;
 - (ii) të drejtë për të marrë dhe qarkulluar të gjitha autorizimet dhe njoftimet që kërkohen me ligj për ekzekutimin e kësaj kontrate;
 - (iii) kjo Kontratë dhe të gjithë dokumentet e tjerë që duhet të ekzekutohen në lidhje me të dhe në të cilat Pranuesi është palë, krijojnë aktualisht apo në të ardhmen, në momentin që ekzekutohen, detyrime të vlefshme të Pranuesit, sipas kushteve përkatëse.
- b. Nuk kërkohet asnjë leje, miratim, autorizim, apo deklaram, depozitim ose regjistrim, nga asnjë autoritet qeveritar apo rregullator, nga dhe në emër të Pranuesit, në lidhje me lidhjen, zbatimin, përfundimin e kësaj Kontrate nga Pranuesi, apo përmbushjen nga Pranuesi të detyrimeve të miratuara këtu.
- Zbatimi dhe përfundimi i kësaj Kontrate nga ana e Pranuesit dhe përmbushja e detyrimeve të miratuara këtu:
- i. nuk do të çenojë asnjë klauzolë ligjore të legjislacionit të zbatueshëm në fuqi;
 - ii. nuk do të kërkojë ndonjë leje, ose depozitim, ose njoftim të çdo autoriteti qeveritar apo rregullator sipas çdo klauzole të ligjit në fuqi apo rregulloreje.

NENI 5

ZGJIDHJA E KONTRATËS DHE PASOJAT

- 5.1 Kjo kontratë për dhurimin e kuotës do të zgjidhet në rast të:
- 5.1.1 Mos plotësimit të detyrimeve të marra përsipër nga ndonjëra prej palëve.
- 5.1.2 Mos realizimin e transferimit të pronësisë mbi kuotën, objekt i kësaj kontrate, në Datën e Transferimit, për shkak të mosveprimeve apo veprimeve me faj ose neglizhencë të ndonjërës prej palëve.
- 5.1.3 Në rastin e forcave madhore, në rastet e luftës e të trubullirave civile, në raste të shkatërrimit të pronës së shkaktuar nga tërmeti, shkatërrimi, kur këto fakte ndodhin para Datës së Transferimit.
- 5.2 Në rastin e zgjidhjes së kontratës për vërtetimin e fakteve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni asnjëra nga palët nuk paguan në favor të tjetrës dëmet eventuale që mund të shkaktohen.

NENI 6

LIGJI QË DO TË ZBATOHE

- 6.1. Kjo Kontratë do të rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet e Shqipërisë. Ndonjë çështje e cila nuk është parashikuar në këtë kontratë do të rregullohet sipas dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe parimet e përgjithshme të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- 6.2. Çdo mosmarrëveshje apo pretendim që mund të lindë në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate ose e lidhur me të, apo çdo shkelje që rrjedh prej kësaj do t'i nënshtrohet zgjidhjes me mirëkuptim të



palëve në këtë kontaktë. Në rast se nuk do të arrihet zgjidhja me pajtim, Gjykata kompetente për zgjidhjen e konfliktit do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

NENI 7

TË NDRYSHME

7.1. Kjo Kontratë mund të amendohet, ndryshohet dhe shtohet vetëm sipas marrëveshjes së shkruar të Palëve.

7.2. Të gjithë njoftimet apo komunikimet e tjera që burojnë prej këtu, duhet të jenë në formë të shkruar dhe duhet të konsiderohen të dhëna efektive: (i) përmes dërgimit jo në rrugë postare në qoftë se dorëzohen personalisht; (ii) përmes dërgimit në rrugë postare në qoftë se dorëzohen nga korrieri; ose (iii) përmes njoftimit të marrjes në qoftë se jepen me anë të telefaksit që konfirmohet me anë të postës rekomande. Në cdo rast njoftimi ose dërgimi do të bëhet në adresat e palëve të specifikuar në hyrje të Kontratës. Për cdo ndryshim të adresave palët detyrohen të njoftojnë njëra tjetrën në kohë të përshtatshme.

7.3 Kjo Kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj dhe së bashku me të gjitha anekset shoqëruese, përbëjnë Kontratën e tërë dhe mirëkuptimin e Palëve në lidhje me objektin e saj. Kjo kontratë përfshin të gjitha marrëveshjet paraprake, verbale apo të shkruara, premtimet dhe garancitë e dhëna nga palët, por gjithnjë duke patur fuqi ligjore mbi to.

NENI 8

GJUHA E KONTRATËS

Kjo Kontratë është përgatitur në gjuhën Shqipe dhe përbëhet nga 3 (tre) faqe dhe është hartuar në 3 (tre) kopje origjinale.

Kontrata u redaktua prej meje noterit në tre ekzemplare, ju lexua palëve me ze të lartë dhe të qartë, iu perkthye nga gjuha shqipe në gjuhën angleze nga perkthyesi Fatmir Laçe, me nr. personal E90501184R, të cilet deklarojnë se e kuptuan dhe meqenë shpreh vullnetin e tyre të lire dhe të plote, e pranuan dhe e nënshkruan atë në prani time dhe une e vertetoj sipas ligjit.

PALA DHURUESE

Ozkan Kiper

OZKAN KIPER

PALA PRANUESE E DHURIMIT

Eda Kiper

Eda Kiper



NOTERE

XHOANA OMARI



Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Katë XII
TIRANë, SHQIPERË
TEL/FAX: 355 4 2420005
TEL: 355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

REZULTATET E KERKIMIT


Numri i Rezultatit të kerkimit:	D-20250913112833286
Data e Rezultatit të Kerkimit:	13.09.2025
Ora e Rezultatit të Kerkimit:	11:28:33
Lloji i Kerkimit:	Emri i Personit Fizik
Numri i Dokumentit:	D-400-125-4102

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0

ÖZKAN RECEP KIPER

Fundi i Rezultatit të Kerkimit

Fundi i Dokumentit



Eriona Hysaj



Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANË, SHQIPËRI
TEL/FAX: 355 4 2420005
TEL: 355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

REZULTATET E KERKIMIT

Numri i Rezultatit të kerkimit:	D-20250913112833286
Data e Rezultatit të Kerkimit:	13.09.2025
Ora e Rezultatit të Kerkimit:	11:28:33
Lloji i Kerkimit:	Emri i Personit Juridik
Numri i Dokumentit:	D-400-125-4102

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0

BABIL SH.P.K.

Fundi i Rezultatit të Kerkimit

Fundi i Dokumentit



SUBJEKTI KERKUES:

Erisa Hysaj

Emertimi

FATMIR HALIT LACEJ P.F.

TE DHENAT E PERDORUESIT:

Emri dhe Mbiemri

Erisa Hysaj



Data e shtypit: 13.09.2025

Faqja 2 e 2

Ora e shtypit: 11:28:33